



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 04.09.2026

**MBLEDHJA Nr. 41,
Datë 09.09.2026, ora 11:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 59/2026, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 09.09.2026, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 41 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin gusht 2026 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 159, datë 31.07.2024, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG”, i ndryshuar.
6. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**